



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E APELIT  
T I R A N E**

**Nr. 34 Regj. Themeltar  
Dt. 08.02.2012**

**Nr. 32/ 1010 Vendimi  
Dt.01.03.2012**

**V E N D I M**

**NE EMER TE REPUBLIKES**

**Gjykata e Apelit Tirane e perbere nga gjyqtaret:**

**KRYESUES: GRAMOZ LEVANAJ  
ANETAR: AGRON PAPAJANI  
ANETARE: VALDETE HOXHA**

Sot me daten **01.03.2012**, mori ne shqyrtim kerkesen penale, qe u perket pjesemarrsesve ne proces:

**KËRKUES:** **SKY PETROLEUM INC**, person juridik i se drejtes se SHBA, perfaqesuar nga av.Fatos Lazimi.

**OBJEKTI:** Njohje vendimi mbi sigurimin e objektit te padise.

**BAZA LIGJORE :** Neni 393 e vijues te K.Pr.Civile.

## GJYKATA E APELIT TIRANE

Pasi shqyrtoi ceshtjen, degjoi relacionin e kryesuesit Gramoz Levanaj, degjoi kerkuesin Sky Petroleum INC perfaqesuar nga av.Fatos Lazimi kerkoi pranimin e kerkeses, pasi bisedoi e analizoi ceshtjen ne teresi,

### VEREN

Kerkuesi Sky Petroleum INC eshte nje shoqeri e te drejtes se SHBA e cila pas kerkeses se paraqitur ne Gjykatën e Teksasit SHBA, me objekt marrjen e mases per sigurimin e padise, per ti paraprire padise qe ka paraqitur prane Arbitrazhit Nderkombetare te Dhomes Nderkombetare te Tregtise (ICC) ne Zyrih, Zvicer, i eshte pranuar kerkesa nepermjet vendimit te ndermjetem te Gjykates se Teksasit e cila ka urdheruar marrjen e mases se sigurimit te objektit te padise.

Nepermjet Kontrates se Hidrokarbure per Ndarjen, Prodhimin Zhbullimin, Zhvillimin dhe Prodhim Hidrokarburesh (marreveshje hidrokarburesh), Agjensia Kombetare e Burimeve Natyrore (AKBN) i ka dhene shoqerise Sky Petroleum INC operimin e Bllokut 4, 5 si dhe Bllokut te Dumrese. Si rrjedhoje e nje mosmarreveshje qe ka lindur ne lidhje me pretendimin e mospermbushjes se disa detyrimeve kontraktore, AKBN i ka njoftuar shoqerise Sky Petroleum INC, zgjidhjen e kontrates se siperpermendur. Duke mos qene dakort me shkaqet dhe procedure e ndjekur per zgjidhjen e kontrates e ka referuar mosmarreveshje prane Dhomes Nderkombetare te Tregtise (ICC) ne Zvicer sipas rregullave te UNCITRAL. E drejta per zgjidhjen e mosmarreveshjeve nepermjet arbitrazhit nderkombetare eshte parashikuar ne nenin XXI te marveshjes se hidrokarbureve e titulluar “Mosmarreveshjet dhe arbitrimi” e cila parashikon se : “ *Cdo mosmarreveshje, konflikt, pretendim apo debat opinjonesh qe buron ose ka lidhje me kete kontrate ose me shkelje, perfundimin ose vlefshmerine e saj ne lidhje me operacionet e hidrokarbureve te kryera me poshte do te zgjidhen perfundimisht me arbitrazh ne perputhje me rregullat e arbitrazhit te UNCITRAL.* ”

Neni 394 i K.P.Civile parashikon se : “ *Vendimit të një gjykate të shtetit të huaj nuk i jepet fuqi në Republikën e Shqipërisë kur:*

*a. sipas dispozitave që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë, mosmarrëveshja nuk mund të jetë në kompetencën e gjykatës së shtetit që ka dhënë vendimin;*

*b. kërkesëpadia dhe letërthirrja për në gjyq nuk i është njoftuar të paditurit në mungesë, në mënyrë të rregullt e në kohë, për t'i dhënë atij mundësi që të mbrohet;*

*c. midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt e për të njëjtin shkak, është dhënë një vendim tjetër i ndryshëm nga gjykata shqiptare;*

*ç. është duke u shqyrtuar nga gjykata shqiptare një padi që është ngritur përpara se vendimi i gjykatës së shtetit të huaj të ketë marrë formë të prerë;*

*d. i është dhënë forma e prerë në kundërshtim me legjislacionin e tij;*  
**dh. nuk pajtohet me parimet bazë të legjislacionit shqiptar.”**

Ne neni 396 te K.Pr.Civile parashikon se : “ *Kërkesës për t'i dhënë fuqi vendimit të gjykatës së huaj duhet t'i bashkëngjiten:*

*a. kopja e vendimit që duhet të zbatohet dhe përkthimi i tij në gjuhën shqipe i legalizuar nga noteri;*

*b. vërtetim nga gjykata që e ka nxjerrë vendimin se ai ka marrë formë të prerë, si edhe përkthimi e legalizimi noterial i tij. Si kopja e vendimit ashtu edhe vërtetimi se vendimi ka marrë formë të prerë, duhet të jenë vërtetuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë;*

*c. prokura, në rast se kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i të interesuarit, e përkthyer dhe e legalizuar te noteri.”*

Neni 397 i K.P.Civile parashikon se: “ *Gjykata e Apelit nuk e shqyrton ceshtjen ne themel, por vetem kontrollon nese vendimi i paraqitur nuk permban dispozita qe vijne ne kundërshtim me nenin 394.*

*Per kerkesn e paraqitur gjykata e apelit jep vendim.”*

Nga shqyrtimi i cesaj ceshtje rezulton se vendimi mbi sigurimin e objektit te padise te Gjykatën e Teksasit SHBA nuk ka marre forme te prere sipas parimeve baze te legjislacionit shqiptar, i parashikuar ne nenin 394/dh te K.Pr.Civile.

Po ashtu rezulton se kerkuesi shoqeria Sky Petroleum INC nuk ka ndjekur procedure per zgjidhjen e kontrates per mosmarreveshje prane Dhomes Nderkombetare te Tregtise (ICC) ne Zvicer sipas rregullave te UNCITRAL, ashtu sikurse eshte sanksionuar ne nenin XXI te kontraes se hidrokarbureve.

Nisur nga analiza e mesiperme kerkesa e bere ne Gjykatën e Apelit nga kerkuesi Sky Petroleum INC per njohje vendimi mbi sigurimin e objektit te padise te Gjykatën e Teksasit SHBA nuk eshte e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet te rrezohet.

**PER KETO ARSYE**

Gjykata e Apelit Tirane, bazuar ne nenin 394 te Kodit Pr.Civile;

**V E N D O S I**

- Rrezimin e kerkeses me kerkues Sky Petroleum INC.
- Kunder ketij vendimi lejohet ankim brenda 30 diteve ne Gjykatën e Larte.

**Tirane ne date 01.03.2012.**

<b>ANETAR</b>	<b>ANETARE</b>	<b>KRYESUES</b>
<b>Agron PAPAJANI</b>	<b>Valdete HOXHA</b>	<b>Gramoz LEVANAJ</b>

**Vertetohet se ky vendim ka marre forme te prere**

**KANCELAR**

**Altin GJANA**